



**Universiteti  
Europian i  
Tiranës**



**BASHKIA  
TIRANË**

Nr. 03 Prot. Datë 08/01/2020

Nr. 2160 Prot. Datë 15/01/2019

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

**“Universiteti Europian i Tiranës” sh.p.k.**, me seli në: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Njësia Administrative Nr.7, kodi postar 1023, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K62029010L, përfaqësuar nga **Znj. Elona Shehu** në cilësinë e Administratorit, këtu e më poshtë referuar si **“UET”**.

dhe

**Bashkia e Tiranës**, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, Nd. 2, kodi postar 1001, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Erion Veliaj**, këtu e më poshtë referuar si **“Bashkia”**.

### Neni 1

#### Objekti i Bashkëpunimit

Objekti i këtij memorandumi është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit midis UET dhe Bashkisë së Tiranës. Institucionet e mësipërme bien dakord të bashkëpunojnë për një afat 5 – vjeçar me njëra-tjetrën në fushat ku të dyja palët ushtrojnë aktivitetin e tyre kryesor dhe/ose plotësues. Pikat kryesore të bashkëpunimit do të jenë:

#### I. Kualifikim / Specializime

UET do të ofrojë mundësinë për kualifikime afatgjata të ciklit Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor, Master Ekzekutiv dhe Doktoraturë. Gjithashtu, do të ofrojë mundësinë e trajnimeve të certifikuara 3-12 javore në marketing, kërkim tregu, komunikim-biznes, menaxhim financiar, etj.

#### II. Konsulencë

UET do të ofrojë konsulencë të specializuar në një numër fushash, siç janë shërbimet e marrëdhënieve publike, marketingut, planet e kërkimit e tregut, shërbime juridike, shërbime të IT-së, shërbime që lidhen me arkitekturën etj.

### **III. Praktikë dhe Punësim**

Bashkia Tiranë në përputhje me Rregulloren “Mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë” miratuar me vendimin nr. 8695/1, datë 22.02.2019, do të mundësojë kryerjen e praktikës për studentët e Universitetit Europian të Tiranës.

Ndërsa mundësia e punësimit të studentëve pranë Bashkisë Tiranë, jepet në respektim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (Ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014) dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

#### **Neni 2**

##### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

- Palët marrin përsipër që në përputhje me interesat institucionale, mundësitë e tyre dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale, për arritjen e qëllimeve që parashikon ky memorandum.

Palët do të ruajnë konfidencialitetin e njëra-tjetrës, për të cilat do të vendosen në dijeni si rrjedhojë e bashkëpunimit të ndërsjelltë.

Palët do të nxisin njëra-tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjerë dhe intensiv duke eksploruar fusha të tjera bashkëpunimi.

#### **Neni 3**

##### **Interpretimet**

Palët do të interpretojnë çdo pikë të këtij memorandumi duke marrë parasysh vullnetin dhe dëshirën e mirë të secilës prej palëve, për nënshkrimin e këtij memorandumi.

Ky memorandum bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.

#### **Neni 4**

##### **Komunikimi**

Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për zbatimin e memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efektiv. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumi janë:

##### **Për Bashkia Tiranë:**

Znj. Marsida Thartori, Specialiste, Sektori i Trajnimit dhe Zhvillimit.

email: [marsida.thartori@tirana.al](mailto:marsida.thartori@tirana.al)

Mob.+355 69 33 60 305

##### **Për UET:**

Znj. Adela Danaj, Drejtore e Zyrës së Karrierës dhe Alumni

e-mail: [adela.danaj@uet.edu.al](mailto:adela.danaj@uet.edu.al);

Mob.+355 69 81 33 227

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja e Memorandumit**

Kohëzgjatja e këtij memorandumi do të jetë për një afat 5 - vjeçar.



Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë, me marrjen e njoftimit me shkrim nga njëra palë. Palët marrin përsipër t'u përmbahen termave dhe kushteve të projektit duke ofruar dhe shkëmbyer informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, deri në përfundim të bashkëpunimit.

**Neni 6  
Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të dy palëve të përfshirë në të. Sipas rastit, për bashkëpunime specifike palët do të nënshkruajnë një akt të dytë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Neni 7  
Hyrja në fuqi**

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

**Universiteti Europian i Tiranës sh.p.k**

**Administratori**

**Znj. Elona Shehu**

ELONA SHEHU

  


**Bashkia Tiranë**

**Kryetar**

**Z. Erion VELIAJ**

  
